

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shfrytëzonte vajza nga Europa Lindore për prostitucion, kapet në Peshkopi i dënuari me 9 vite burg në It ali - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/shfrytezonte-vajza-nga-europa-lindore-per-prostitucion-kapet-ne-peshkop-i-i-denuari-me-9-vite-burg-ne-itali/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:14:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:02:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	677a402e48c7177d2e0ac719881381d2a3ecb54c1156fcaed41550a4c584aac8
TEKSTI	af6a9929719c8af8598ce9d908637eea6477ff7af41bfb5e2820936e174e2e07
PAMJA	b9cfe087b81d350d67812cfd5e375256ef2a2b66de927ad0d8633f96537e5a26

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	38ec3f1b556e75c9c0c76983c1f3c9a9aacf97018b564debe5a8dc5663df050d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/38ec3f1b556e75c9c0c76983c1f3c9a9aacf97018b564debe5a8dc5663df050d

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Shfrytëzonte vajza nga Europa Lindore për prostitucion, kapet në Peshkopi i dënuari me 9 vite burg në Itali

AKTUALITET

Demo

Shfrytëzonte vajza nga Europa Lindore për prostitucion, kapet në Peshkopi i dënuari me 9 vite burg në Itali

SEPTEMBER 18, 2026



Gëzim Dani alias Gëzim Hidri, i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane është kapur në Peshkopi, në kuadër të operacionit "Fast".

40-vjeçari, i dënuar nga drejtësia italiane me 9 vite burgim për veprat penale "Organizata kriminale" dhe "Shfrytëzimi i prostitucionit", u lokalizua dhe arrestua falë bashkëpunimit të FAST Albania me strukturat e Policisë së Shtetit dhe autoritetet homologe italiane.

"Policia e Shtetit. Finalizohet nga Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, në bashkëpunim me DVP Dibër, faza e radhës e operacionit të koduar "Fast".

Kapet në Peshkopi, 1 shtetas me rrezikshmëri të lartë shoqërore, i dënuar në Itali, me 9 vjet burgim, për veprat penale "Organizata kriminale" dhe "Shfrytëzimi i prostitucionit".

Në vijim të bashkëpunimit nëpërmjet Interpol Tiranës dhe homologëve në Itali, për lokalizimin dhe kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim ndërkombëtar, specialistët e Sektorit për Kërkimin (FAST Albania) në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale në DPPSh, në bashkëpunim me shërbimet e DVP Dibër, finalizuan një tjetër fazë të operacionit të koduar "Fast", gjatë së cilës u kap në Peshkopi dhe u arrestua shtetasi:

-Gëzim Dani alias Gëzim Hidri, 40 vjeç.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, Itali, pasi Gjykata e Apelit e Napolit, me vendimin e datës 15.11.2021, e ka dënuar me 9 vjet burgim, për veprat penale "Organizata kriminale" dhe "Shfrytëzimi i prostitucionit", sepse ka shfrytëzuar vajza nga Evropa Lindore, për prostitucion, në zonën e Napolit, në vitin 2009.

Interpol Tirana, në bashkëpunim me Interpol Romën, vijon procedurën për ekstradimin e 40-vjeçarit, në Itali, shkruan Policia.

9 vite burg arrestim hetime I dënuar në Itali itali krim operacion policor Peshkopi policia prostitucion shfrytëzim prostitucionit shqipëri trafikim Vajza nga Europa Lindore

SHARE.

Postimet e reja

U kap nga droni teksa kujdesej për parcelën e...

SEPTEMBER 18, 2026

Shfrytëzonte vajza nga Europa Lindore për...

SEPTEMBER 18, 2026

Operacioni "The Wanted"/ Arrestohen në Itali dy...

SEPTEMBER 18, 2026

Ngjarja në Sarandë/ Vëllai i një prej të arrestuarve...

SEPTEMBER 18, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu